



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.208/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MC Catering” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-82107-12-14-2020, me objekt Loti I – *Blerje mish vici, mish pule dhe vezë*” me fond limit 39 274 333 (tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Ankimues: “MC Catering” SHPK
Rruga “Pjetër Budi”, Nd.29, H.3, Ap.14 Tiranë

Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
Bashkia Tiranë
Rr. “Barrikadave”

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.12.2020 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-82107-12-14-2020, me objekt Loti I – *Blerje mish vici, mish pule dhe vezë*” me fond limit 39 274 333 (tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë

e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 18.01.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 27.01.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- MC Caterig	30,396,400	I skualifikuar
- Eagle Cons&Eraldo 2013	32,617,000	I skualifikuar
- Argent Daci	35,955,000	I kualifikuar
- Kazazi Meat&Nelsa	36,268,800	I kualifikuar
- Sead-SGS	38,151,000	I skualifikuar

II.4. Në datën 27.01.2021 operatori ekonomik “MC Catering” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyt si më poshtë vijon.

- *Operatori ekonomik “M.C.CATERING” SHPK 3.1 Kriteret e veçanta pika 1.b për përmbushjen e deklaratës së ofertës së pavarur (shtojca 2/1). Nga verifikimi në sistem referuar ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjekteve, pika 7 “Zyra qendrore e shoqërise” rezulton se; Operatori ekonomik “M.C.CATERING” SHPK dhe anëtari i bashkimit operator “Eagle Cons” SHPK me “Eraldo 2013” SHPK, ka të njëjtën zyrë qendrore me operatorin ekonomik “Eagle Cons” SHPK, ofertues në të njëjtin lot, me adresë të përbashkët; Rruga Pjetër Budi, Nd.29, H.3, ap.14 Njësia Administrative Nr.2, 1010.*
- *Gjithashtu pas verifikimit të shtojcës 8 “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” rezulton se, personat në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të operatorëve respektivë, të kenë të njëjtën atësi, mëmësi dhe ditëlindje, pra janë motër e vëlla (binjakë). Ky fakt bie ndesh me pikën 6 të shtojcës 2/1, gërma a “ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurent tjetër”, dhe cenon Ligjin Nr.9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2.ç “Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë”, pika d “Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrë në procedurat e prokurimit publik”, si dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika a “Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i ofertuesve dhe kandidatëve”.*

- 3.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.12 operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar: Mishi i vicit është paraqitur i mbështjellë me qeskë polietileni. Për ambalazhin e mishit të viçit, OE ka paraqitur: Dokument të lëshuar nga “Lotrene FE3000” me të dhënat mbi “Polietilenin me dendësi të ulët” ku përcaktohet se produktet e prodhuara janë të përshtatshme për t’u përdorur në kontakt me ushqimin. OE ka paraqitur Certifikatë të Analizës dhe Konformitetit lëshuar nga “Muntajat”. Duke verifikuar “qeskën e ambalazhit” me të cilën janë ambalazhuar mostrat e paraqitura të mishit, **Komisioni konstaton se mbi qeskën e ambalazhit nuk ka asnjë shënim, mbishkrim apo stampim të prodhuesit të qeskës**, për këtë arsye, Komisioni nuk mund të vërtetojë se Certifikatat e cilësisë të paraqitura nga OE, përfaqësojnë qeskën me të cilat është ambalazhuar mostra e paraqitur.
- Për ambalazhin e mishit të pulës, OE ka paraqitur: Dokumentin e përkthyer dhe të noterizuar “Deklaratë e përputshmërisë BE IDO IDS” të lëshuar nga “Gruppo Fabbrri Vignola S.P.A me datë 23.05.2016, “Për materiale që synohet të jenë në kontakt me ushqimin, për qeskën plastike (film plastik). Dokumentin e përkthyer dhe të noterizuar “Deklaratë përputhshmërie e materialeve dhe objekteve që synohen të vijnë në kontakt me produktet ushqimore” të lëshuar nga “Coopbox Eastern s.r.o. me datë 17.01.2017, për produktet PAKETIM STANDARD të tabakave PSE. Duke verifikuar “qeskën e ambalazhit” me të cilën janë ambalazhuar mostrat e paraqitura të mishit të pulës, dhe vasketat në të cilat ato janë vendosur, Komisioni konstaton se mbi qeskën e ambalazhit dhe të vasketave nuk ka asnjë shënim, mbishkrim apo stampim të prodhuesit të tyre, për këtë arsye, Komisioni nuk mund të vërtetojë se Certifikatat e cilësisë të paraqitura nga OE, përfaqësojnë qeskën apo vasketën me të cilat është ambalazhuar mostra e paraqitur

II.5. Në datën 29.01.2021 operatori ekonomik “MC Catering” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Lidhur me arsyen e skualifikimit se Operatori ekonomik “M.C.CATERING” SHPK 3.1 Kriteret e veçanta pika 1.b për përmbushjen e deklaratës së ofertës së pavarur (shtojca 2/1). Nga verifikimi në sistem referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjekteve, pika 7 “Zyra qendrore e shoqërisë”rezulton se; Operatori ekonomik “M.C.CATERING ” SHPK dhe anëtari i bashkimit operator “Eagle Cons” SHPK me “Eraldo 2013” SHPK, ka të njëjtën zyrë qendrore me operatorin ekonomik “Eagle Cons” SHPK, ofertues në të njëjtin lot, me adresë të përbashkët; Rruga Pjetër Budi, Nd.29, H.3, ap.14 Njësia Administrative Nr.2, 1010.
Shoqëria MC Catering SHPK e regjistruar në QKB prej vitit 2007 dhe me një aktivitet të pasur tregëtar deri më tani është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm dhe administrator të shoqërisë z. Gentjan Prençi . Ortaku i kësaj shoqërie nuk figuron ortak në asnjë kompani tjetër në RSH (as në shoqërinë Eagle Cons SHPK) për rrjedhojë ky individ

as nuk ndikon në vendimarrjen e një operatori tjetër ekonomik dhe as nuk ndikohet në vendimarrje nga asnjë operator tjetër ekonomik.

Kriteret e vecanta pika 1.b për përmbushjen e deklaratës së ofertës së pavarur (shtojca 2/1) është paraqitur nga operatori MC Catering SHPK në mënyrë të rregullt, firmosur nga administratori i kësaj shoqërie. Të gjitha deklaratimet janë dhënë në përgjegjësi të plotë nga administratori i shoqërisë i cili theksojmë ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar, dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër.

Për sa më lart ky pretendim nuk qëndron.

- Lidhur me arsyen e skualifikimit se Gjithashtu pas verifikimit të shtojcës 8 “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” rezulton se, personat në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të operatorëve respektivë, të kenë të njëjtën atësi, mëmësi dhe ditëlindje, pra janë motër e vëlla (binjakë). Ky fakt bie ndesh me pikën 6 të shtojcës 2/1, gërma a “ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, dhe cënon Ligjin Nr.9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2.ç “Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik”, pika d “Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrë në procedurat e prokurimit publik”, si dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika a “Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i ofertuesve dhe kandidatëve”.

KVO e institucionit tuaj duhet ta dijë shumë mirë se shtojca 8 Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme është për të vërtetuar se shoqëria është e regjistruar si person juridik, operatori nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 45/1 të LPP, operatori nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, nuk është në proces falimentimi, ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi si dhe personat që kanë kompetencë në vendimarrje (në këtë rast z. Gentjan Prenci si ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë) nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë për asnjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 45/1 të LPP.

Operatori MC Catering SHPK si dhe z. Gentjan Prenci (ortak i vetëm dhe njëherazi administrator i shoqërisë) përmbushin të gjitha pikat e shtojcës 8.

Ashtu sikur sqaruar edhe në pikën 1, pika 6 e shtojcës 2/1 oferta nga ana e shoqërisë MC Catering SHPK është hartuar në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër.

Ky pretendim nga ana e KVO është hamendësim i tyrë dhe i pabazuar në ligj, pavarësisht marrëdhënies së përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë të ndryshëm jemi të lirë sipas të gjitha ligjeve të RSH, gjithmonë duke respektuar ligjet të krijujmë dhe zhvillojmë aktivitetin tonë si persona juridikë përtej gjykimeve dhe hamendësimeve në tymnajë të kësaj KVO-je

apo kujdo tjetër, sipas së cilës në një familje paska të drejtë vetëm një anëtar në familje të krijojë biznes dhe asnjë tjetër. Mqs se KVO i është referuar ekstrakteve të shoqërisë ju lutem lexoni mirë Ekstraktet Historike respektive të shoqërisë Eagle Cons SHPK si dhe të MC Catering në asnjë moment këto dy shoqëri nuk kanë qenë me individë të njëjtë të përfshira në këto shoqëri por tërësisht të pavarura në aktivitetin e tyre tregtar.

Në cilin ligj të RSH parashikohet se dy anëtarë nga e njëjta familje nuk paskan të drejtë të ketë secili më vete biznesin e tyre të rregullt sipas të gjitha ligjeve dhe rregullave??

Ajo që bie në sy është se si kjo KVO për të njëjtin kriter abstrakt të vendosur në mendjen e tyre veprojnë me dy standarde kur në këtë procedurë prokurimi Blerje ushqime për vitin 2021 kanë marrë pjesë në disa lote por edhe në të njëjtin lot njëherazi operatorë ekonomikë të tjerë të cilët kanë po këtë marrëdhënie të administratorit dhe ortakut të shoqërisë përkatësisht motër e vëlla apo diferenca është se nuk janë binjakë dhe në këtë rast nuk përbëka problem. Konkretisht operatori Erdis me ortak dhe adm të vetëm Elvis Balla dhe operatori ekonomik Nelsa SHPK me ortak dhe adm të vetëm Elsa Kamberi janë motër e vëlla dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në të njëjtin ambient dhe kanë marrë pjesë në të njëjtën procedurë konkurimi dhe po në të njëjtin lot. Sipas logjikës së KVO edhe këta dy OE duhet të skualifikohen po ashtu si ne???

Gjthashtu shoqëritë Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK edhe për vitet 2018-2019 në të njëjtën adresë në ekstrakt, me të njëjtën ortake të vetme në shoqëritë respektive po ashtu binjake edhe në procedurat e zhvilluara nga institucioni juaj janë kualifikuar si ofertues të suksesshëm nga po e njëjta KVO.

E vetmja përgjigje që gjen vend është se këtë vit KVO ka patur operatorë ekonomikë preferencialë dhe kanë preferuar të shkelin jo vetëm ligjin me dy këmbë por të bien ndesh edhe me veten e tyre duke skualifikuar dy operatorë të ndodhur në të njëjtat kushte si i kanë kualifikuar edhe vjet.

Për sa më lart ky pretendim nuk qëndron.

- *Lidhur me arsyen e skualifikimit 3.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.12 operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar: Mishi i vicit është paraqitur i mbështjellë me qeskë polietileni. Për ambalazhin e mishit të viçit, OE ka paraqitur: Dokument të lëshuar nga “Lotrene FE3000” me të dhënat mbi “Polietilenin me dendësi të ulët” ku përcaktohet se produktet e prodhuara janë të përshtatshme për t’u përdorur në kontakt me ushqimin. OE ka paraqitur Certifikatë të Analizës dhe Konformitetit lëshuar nga “Muntajat”. Duke verifikuar “qeskën e ambalazhit” me të cilën janë ambalazhuar mostrat e paraqitura të mishit, Komisioni konstaton se mbi qeskën e ambalazhit nuk ka asnjë shënim, mbishkrim apo stampim të prodhuesit të qeskës, për këtë arsye, Komisioni nuk mund të vërtetojë se Certifikatat e cilësisë të paraqitura nga OE, përfaqësojnë qeskën me të cilat është ambalazhuar mostra e paraqitur.*

- *Për ambalazhin e mishit të pulës, OE ka paraqitur: Dokumentin e përkthyer dhe të noterizuar “Deklaratë e përputshmërisë BE IDO IDS” të lëshuar nga “Gruppo Fabbrri Vignola S.p.A me datë 23.05.2016, “Për materiale që synohet të jenë në kontakt me ushqimin, për qeskën plastike (film plastik). Dokumentin e përkthyer dhe të noterizuar “Deklaratë përputshmërie e materialeve dhe objekteve që synohen të vijnë në kontakt me produktet ushqimore” të lëshuar nga “Coopbox Eastern s.r.o. me datë 17.01.2017, për produktet PAKETIM STANDARD të tabakave PSE. Duke verifikuar “qeskën e ambalazhit” me të cilën janë ambalazhuar mostrat e paraqitura të mishit të pulës, dhe vasketat në të cilat ato janë vendosur, Komisioni konstaton se mbi qeskën e ambalazhit dhe të vasketave nuk ka asnjë shënim, mbishkrim apo stampim të prodhuesit të tyre, për këtë arsye, Komisioni nuk mund të vërtetojë se Certifikatat e cilësisë të paraqitura nga OE, përfaqësojnë qeskën apo vasketën me të cilat është ambalazhuar mostra e paraqitur*

*Referuar DT 2.3 Kriteret e vecanta të kualifikimit 2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një moster sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor për secilin artikull të kerkuar. Mostrat do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK me adresë Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tirane. Mostrat e kerkuara duhet të kenë një etiketë e cila të përmbajë elementet: moster “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Ditën e paraqitjes së mostrave, operatori ekonomik duhet të paraqesë për secilin nga artikujt e lotit së bashku me mostrat edhe dëshmi të rezultateve të testimeve zyrtare, origjinale ose kopje të noterizuar (të lëshuara nga institucione të autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike). **Mungesa e mostres është kusht skualifikues.***

Në përmbushje të këtij kriteri datën e hapjes së ofertave janë dorëzuar nga shoqëria MC Catering mostra për artikujt Mish vici, Mish pule dhe Vezë. Konkretisht për artikullin Mish Vici i cili përmban të gjitha kërkesat e specifikimeve teknike konkretisht: 2 mostra me peshë 2.12 kg dhe 1.72 kg. Mishi është shoqëruar me certifikatë veterinare nr.55 datë 17.01.2021 në përmbushje të kërkesës në shtojcën 11 specifikimet teknike ”Mishi duhet të shoqërohet cdo ditë me raport veterinar. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë. Raporti veterinar duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar. Mostrat e mishit janë ambalazhuar në qese të lejuara për këtë artikull (në përputhje me kërkesën në specifikime teknike) shoqëruar me certifikatë të analizës dhe konformitetit datë 15.02.2017 lëshuar nga Lotrene FE3000 për polietilenin me dendësi të ulët e cila tregon përputhshmërinë e materialit të prodhimit të qeses pasi duhet të informohet mirë KVO nuk ka certifikatë cilësie për qesen në vecanti por për materialin e prodhimit të qeses. Në asnjë qese nuk ka stampim të prodhuesit të qeses dhe për më tepër një gjë e tillë nuk është kërkuar as tek kriteret e vecanta të kualifikimit as në shtojcën 11 specifikimet teknike që qesja duhet të jetë e stampuar me logon e prodhuesit.

Gjithashtu datën e hapjes së ofertave 18.01.2021 ora 19:45 pas dorëzimit të mostrave është mbajtur procesverbali për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave në prezencë të komisionit të ngritur me urdhër nr.41 datë 15.01.2021 dhe përfaqësuesit të shoqërisë Zjn B.S me anën e të cilit vërtetohet plotësimi i të gjitha kërkesave në lidhje me dorëzimin e mostrave.

Për mishin e pulës janë dorëzuar dy mostra me peshë 1.03 kg dhe 0.724 kg. Mishi është shoqëruar me certifikatë veterinarë nr. 089085 datë 16.01.2021 në përmbushje të kërkesës në shtojcën 11 specifikimet teknike, Mishi duhet të shoqërohet cdo ditë me raport veterinar. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë. Raporti veterinar duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

Mostrat e mishit janë ambalazhuar në qese të lejuara për këtë artikull shoqëruar me certifikatë të analizës dhe konformitetit , dokumentin e përkthyer dhe të noterizuar Deklaratë e përpuethshmërisë BE IDO IDS të lëshuar nga Gruppo Fabbri Vignola SPA më datë 23.05.2016 e cila tregon përputhshmërinë e materialit të prodhimit të qeses pasi duhet të informohet mirë KVO nuk ka certifikatë cilësie për qesen në vecanti por për materilain e prodhimit të qeses. Në asnjë qese nuk ka stampim të prodhuesit të qeses, për më tepër një gjë e tillë nuk është kërkuar as tek kriteret e vecanta të kualifikimit as në shtojcën 11 specifikimet teknike që qesja duhet të jetë e stampuar me logon e prodhuesit. Gjithashtu kemi paraqitur të përkthyer dhe të noterizuar Deklaratën e përpuethshmërisë së materialeve dhe objekteve që synohen të vijnë në kontakt me ushqimin lëshuar nga COOPBOX Eastern sro për vasketën (dok i dorëzuar edhe pse i pa kërkuar në DT).

Edhe për mostrën Mish Pule datën e hapjes së ofertave 18.01.2021 ora 19:45 pas dorëzimit të mostrave është mbajtur procesverbali për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave në prezencë të komisionit të ngritur me urdhër nr.41 datë 15.01.2021 dhe përfaqësuesit të shoqërisë Zjn B.S me anën e të cilit vërtetohet plotësimi i të gjitha kërkesave në lidhje me dorëzimin e mostrave.

Për artikullin vezë janë dorëzuar 2 mostra konkretisht 2 bigerina me nga 30 kokra secila me peshë 65/g/kokërr të futura në kuti ambalzahi me kapacitet 360 kokrra të shënuar datën e skadencës 03.02.2021 në përmbushje të plotë të të gjitha kriterëve të kërkuara në specifikimet teknike . Vezët janë shoqëruar me raport provë U/34/2021 datë 11.01.2021 nga ISUV me datë skadence 03.02.2021.

Nga ajo që pamë ditën e dorëzimit të mostrave jemi të bindur se asnjë operator tjetër ekonomik pjesëmarrës në këtë lot nuk ka paraqitur mostra me të gjithë elementët e kërkuar sic janë dorëzuar nga MC Catering SHPK. Kërkojmë të bëhet transparent mostrat dhe dokumentacioni shoqëruar i mostrave sipas kërkesave për cdo artikull respektiv dhe të na bindë KVO se kualifikimi i operatorëve ekonomikë Argent Daci dhe Kazazi është bërë në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e vendosura në kriteret e përgjithshme , kriteret e vecanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike.

Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.

II.6. Në datën 02.02.2021 me shkresën nr.118/5 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 08.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.118/8 prot datë 18.02.2021 protokolluar me tonën me nr.209/2 prot datë 22.02.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Referuar arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” SHPK rezulton se, ato lidhen me pretendime të autoritetit kontraktor për shenja paralajmëruese mbi bashkëpunimin mes operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për marrëveshje të ndaluar mes tyre në kuptim të ligjit.

II.10. Për këtë arsye me vendimin Nr.209/4 prot datë 11.03.2021 me objekt “*Urdhër pezullimi i shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik MC Catering SHPK me nr.209 prot datë 08.02.2021*”, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të pezullojë shqyrtimin administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering SHPK me nr. 209 protokollin datë 08.02.2021 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-82107-12-14-2020, me objekt Loti I – Blerje mish vici, mish pule dhe vezë” me fond limit 39 274 333 (tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*
- 2. T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë Komisionin e Prokurimit Publik në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.*
- 3. Të dërgojë, pranë Autoritetit të Konkurrencës, kopje të informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, pjesë e dokumentacionit të administruar në shqyrtimin administrativ nr.209 Protokollin datë 08.02.2021.*

II.11. Me shkresën nr. 134/5 prot datë 29.03.2021, Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 785 datë 25.03.2021 i cili ka vendosur:

- 1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV, Loti V zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*

2. *Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.*

II.12. Me shkresën nr.134/24 prot datë 30.04.2021 Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar Vendimin Nr.796 datë 29.04.2021 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt: Blerje ushqime për vitin 2021 Loti I, Loti IV dhe Loti V të zhvilluara nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, dhe miratimin e angazhimeve të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C Catering SHPK” ku ka vendosur:

1. *Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt Blerje ushqime për vitin 2021 Loti I, Loti IV dhe Loti V të zhvilluara nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*
2. *Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK gjatë pjesmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre:*
 - a) *do të ofertojnë në mënyrë të pavarur pa u konsultuar , pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër në lidhje me cmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e cmimit , qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet apo dërgesa të vecanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar.*
 - b) *do të operojnë me punonjësit e tyre në mënyrë të pavarur si më sipër.*
 - c) *Nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektit të veprimtarisë së shoqërive respektive njëkohësisht me dy oferta të ndryshme.*
3. *Në rast të mospërmblidhjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK në zbatim të nenit 74 pika 1 gërma c të ligjit nr.9121/2003 ndëshkohen me gjobë deri në 10% të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.*
4. *Monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK.*

II.13. Me vendimin Nr.795 datë 12.05.2021 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të përfundojë pezullimin e shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering shpk me nr. 209 protokoli datë 08.02.2021 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-82107-12-14-2020, me objekt Loti I – Blerje mish vici, mish pule dhe vezë” me fond limit 39 274 333 (tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MC Catering” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Operatori ekonomik “M.C.CATERING” SHPK 3.1 Kriteret e veçanta pika 1.b për përmbushjen e deklaratës së ofertës së pavarur (shtojca 2/1). Nga verifikimi në sistem referuar ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjekteve, pika 7 “Zyra qendrore e shoqërisë” rezulton se; Operatori ekonomik “M.C.CATERING ” SHPK dhe anëtari i bashkimit operator “Eagle Cons” SHPK me “Eraldo 2013” SHPK, ka të njëjtën zyrë qendrore me operatorin ekonomik “Eagle Cons” SHPK, ofertues në të njëjtin lot, me adresë të përbashkët; Rruga Pjetër Budi, Nd.29, H.3, ap.14 Njësia Administrative Nr.2, 1010.

Gjithashtu pas verifikimit të shtojcës 8 “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” rezulton se, personat në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të operatorëve respektivë, të kenë të njëjtën atësi, mëmësi dhe ditëlindje, pra janë motër e vëlla (binjakë). Ky fakt bie ndesh me pikën 6 të shtojcës 2/1, gërma a “ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, dhe cenon Ligjin Nr.9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2.ç “Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik”, pika d “Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”, si dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika a “Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i ofertuesve dhe kandidatëve”.

III.1.1. Në shtojcën 2/1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe/ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkëngjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo

angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

a) çmimet ;

b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

III.1.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 2/1;

c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;

e.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “MC Catering” SHPK dhe “Eagle Cons” SHPK kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregëtar e subjektit MC Catering SHPK nga ku rezulton se zyra qendrore e shoqërisë është në adresën Tiranë, Rruga Pjetër Budi, Nd.29, H.3, Ap.14, Njësia Administrative nr.2, 1010.
- Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur nënshkruar nga administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë Gentjan Prenci
- Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme nënshkruar nga Gentjan Prenci administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë . Atësia Njazi, Amësia Manushaqe, datëlindja 02.10.1993, Vendlindja Kamëz Tiranë .
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregëtar e subjektit Eagle Cons SHPK nga ku rezulton se zyra qendrore e shoqërisë është në adresën Tiranë, Rruga Pjetër Budi, Nd.29, H.3, Ap.14, Njësia Administrative nr.2, 1010.
- Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur nënshkruar nga administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë Eglantina Prenci.
- Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme nënshkruar nga Eglantina Prenci administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë. Atësia Njazi, Amësia Manushaqe, datëlindja 02.10.1993, Vendlindja Tiranë .

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

III.1.5. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "MC Catering" SHPK është skualifikuar nga autoriteti kontraktor me argumentin se së bashku me operatorin ekonomik pjesëmarrës "Eagle Cons" SHPK ka dyshime se kanë bashkëpunuar në përgatitjen e ofertave të tyre duke ofertuar kështu jo në mënyrë të pavarur. Ky përfundim është nxjerrë nga autoriteti kontraktor pas konstatimit në dokumentacionin e paraqitur nga të dy operatorët pjesëmarrës konkretisht në Ekstraktin e regjistrit tregtar dhe Deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme nga ku rezulton se ortakët e vetëm të shoqërive kanë marrëdhënie familjare mes tyre (motër e vëlla) dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin ambient në adresën Tiranë, Rruga Pjetër Budi, Nd.29, H.3, Ap.14, Njësia Administrative nr.2, 1010.

Në kushtet kur arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues lidhen drejtpërdrejtë me pretendime të autoritetit kontraktor për shenja paralajmëruese mbi bashkëpunimin mes operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për marrëveshje të ndaluar mes tyre në kuptim të ligjit., referuar nenit 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" të ndryshuar parashikohet se: *"Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre, nenit 4 "Marrëveshjet e ndaluara" parashikon shprehimisht se: Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave Marrëveshjet që ndalohen, sipas pikës 1 të këtij neni dhe që nuk përjashtohen sipas neneve 5, 6 dhe 7, janë të pavlefshme, dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi në të cilën kërkohet paraqitja nga ana e operatorëve ekonomikë të shtojcës 2/1 "Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur". Deklaratës për paraqitje oferte të pavarur e cila në paragrafin e dytë të saj parashikon shprehimisht se ajo mbështetet në nenin 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës". në pikën 2 të të cilës parashikohet se: "Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e*

plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;” Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr.209/4 prot datë 11.03.2021 me objekt “Urdhër pezullimi i shqyrtimit administrative të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik MC Catering SHPK me nr.209 prot datë 08.02.2021”, vendosi:

- 1. Të pezullojë shqyrtimin administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering SHPK me nr. 209 protokoli datë 08.02.2021 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-82107-12-14-2020, me objekt Loti I – Blerje mish vici, mish pule dhe vezë” me fond limit 39 274 333 (tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*
- 2. T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë Komisionin e Prokurimit Publik në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.*
- 3. Të dërgojë, pranë Autoritetit të Konkurrencës, kopje të informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, pjesë e dokumentacionit të administruar në shqyrtimin administrativ nr.209 Protokoli datë 08.02.2021.*

III.1.7. . Me shkresën nr. 134/5 prot datë 29.03.2021, Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 785 datë 25.03.2021 i cili ka vendosur:

- 1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV, Loti V zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*
- 2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.*

III.1.8. Me shkresën nr.134/24 prot datë 30.04.2021 Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar Vendimin Nr.796 datë 29.04.2021 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt: Blerje ushqime për vitin 2021 Loti I, Loti IV dhe Loti V të zhvilluara nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, dhe miratimin e angazhimeve të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet “Eagle Cons” SHPK dhe “M.C Catering” SHPK”.

Në seksionin II.2. “Vlerësimi i sjelljes dhe angazhimeve të ndërmarrjeve” të vendimit Nr.796 datë 29.04.2021 Autoriteti i Konkurrencës ka arsyetuar si më poshtë vijon:

10. Nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurën e hapur të prokurimit të zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, më datë 18.01.2021 me objekt Loti I Blerje mish vici, mish pule dhe vezë”, Loti IV “Blerje artikuj ushqimorë” dhe Loti V “Blerje fruta dhe zarzavate” vihet re se:

1. Operatorët ekonomikë Eagle Cons SHPK SHPK dhe MC catering SHPK ortakët e të cilëve kanë lidhje familjare (janë motër e vëlla binjakë) , e zhvillojnë aktivitetin e tyre në të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
2. Operatorët ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK kanë punonjës të përbashkët të cilët merren me përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe ndjekjen e procedurave të tyre pranë Autoritetit Kontraktor.
3. Të dy operatorët ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK kanë autorizuar të njëjtin person për të kryer kampionimin e mostrave pranë ISUV.
4. Nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga këta ofertues për lotin IV Blerje artikuj ushqimorë rezulton se nga 22 artikuj të këtij loti për 16 artikuj janë paraqitur mostra të njëjta nga të dy operatorët ekonomikë . 16 mostrat e paraqitura nga të dy operatorët ekonomikë kanë të njëjtin emërtim, prodhues dhe të njëjtën datë skadence.

11. Referuar shqetësimeve të ngritura nga DPCK Bashkia Tiranë mbi vijimësinë e procedurave të prokurimit objekt hetimi rezulton se jemi përballë një situatë emergjence dhe nevojë ekstreme të furnizimit të përditshëm me ushqime të çerdheve dhe kopshteve publike të Tiranës.

12. Nisur nga kjo situatë e krijuar si dhe duke pasur parasysh që rastet e “zgjidhjes me angazhime” mund të sjellin një ndryshim më të shpejtë dhe efektiv në treg Autoriteti i Konkurrencës ka identifikuar si më sipër shqetësimet e ngritura të konkurrencës të cilat mund të eliminohen me marrjen e angazhimeve nga ana e ndërmarrjeve.

13. Procedurat me angazhime çojnë në marrjen e vendimeve me angazhime të cilat pas miratimit bëhen detyruese për ndërmarrjet të cilave iu adresohet ky vendim si dhe çon në përfundimin e procedurave hetimore për të cilat nuk është e domosdoshme kryerja e të gjitha hapave procedurale të hetimit.

14. Bazuar në rregulloren Për procedurat e angazhimeve e cila ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime në përputhje me nenin 45të ligjit nr.9121/2003 ndërmarrjet MC Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK kanë paraqitur vullnetarisht angazhimet e tyre me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura të konkurrencës në tregun e prokurimit objekt hetimi dhe përmbushjen e menjëhershme të këtyre angazhimeve. Sipas këtyre ndërmarrjeve është keqinterpretuar sjellja e tyre në procedurën e prokurimit objekt i këtij hetimi për shkak të lidhjes familjare që ato kanë.

15. Konkretisht ndërmarrja Eagle Cons SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:

1. Eagle Cons SHPK ka ofertuar deri më sot dhe do të ofertojë në mënyrë të pavarur pa u konsultuar , pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurent tjetër në lidhje me cmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e cmimit , qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë , paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet apo dërgesa të vecanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin nr,9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar.

2. *Eagle Cons SHPK ka operuar dhe do të operojë me punonjësit e saj në mënyrë të pavarur si më sipër.*
3. *Duke qenë se ortakët e shoqërisë Eagle Cons SHPK dhe shoqërisë MC Catering SHPK janë familjarë motër e vëlla në respektim të ligjit nr.9121/2003 me qëllim evitimin e ndonjë keqkuptimi, marrin angazhimin se nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektivit të veprimtarisë së shoqërive respektive njëkohësisht me dy oferta të ndryshme pavarësisht se janë dy shoqëri të pavarura nga njëra tjetra.*

Ndërmarrja MC Catering SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:

1. *MC Catering SHPK ka ofertuar deri më sot dhe do të ofertojë në mënyrë të pavarur pa u konsultuar , pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurent tjetër në lidhje me cmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e cmimit , qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë , paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet apo dërgesa të vecanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar.*
2. *MC Catering SHPK ka operuar dhe do të operojë me punonjësit e saj në mënyrë të pavarur si më sipër.*
3. *Duke qenë se ortakët e shoqërisë MC Catering SHPK dhe shoqërisë Eagle Cons SHPK janë familjarë motër e vëlla në respektim të ligjit nr.9121/2003 me qëllim evitimin e ndonjë keqkuptimi, marrin angazhimin se nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektivit të veprimtarisë së shoqërive respektive njëkohësisht me dy oferta të ndryshme pavarësisht se janë dy shoqëri të pavarura nga njëra-tjetra.*

16. Në zbatim të rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, angazhimet e mësipërme janë marrë nga ndërmarrjet nën hetim për gjithë periudhën kohore në të ardhmen. Këto angazhime janë të qarta , të vetëkëkësueshme si dhe janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrjet.

17. Shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës konsistojnë në dyshimin e një marrëveshjeje në oferta midis operatorëve ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe MC catering SHPK , pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të ushqimeve të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Bashkia Tiranë, sjellje e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim, apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 pika 1 të ligjit nr.9121/2003 Për mbrojtjen e konkurrencës ndryshuar.

18. Angazhimet e depozituara vullnetarisht nga ndërmarrjet MC Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK vlerësohen të përshtatshme për të eliminuar shqetësimet e ngritura të konkurrencës të identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës pasi konkurrenca midis ndërmarrjeve në treg bëhet efektive kur këto ndërmarrje operojnë në mënyrë të pavarur , pa u konsultuar , pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me njëra tjetrën dhe për më tepër kur ndërmarrjet në fjalë marrin përsipër të mos ofertojnë njëkohësisht me dy oferta konkurruese të ndryshme në të njëjtën

procedurë prokurimi , për çdo prokurim që ka për objekt një nga veprimtaritë e tyre duke siguruar ruajtjen e konkurrencës efektive në të gjitha tregjet e prokurimit ku këto ndërmarrje ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre.

19. Sa më sipër vlerësojmë se këto angazhime mund të sjellin një ndryshim më të shpejtë dhe efektiv në treg duke eliminuar shqetësimet e ngritura të konkurrencës në tregun e prokurimit të ushqimeve si dhe duke dhënë garanci për sjelljen e këtyre ndërmarrjeve edhe gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha tregjet e prokurimit ku këto ndërmarrje operojnë sipas objektit të veprimtarisë së tyre.

20. Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 24 shkronja d, nenin 26 , nenin 45 pika 2 të ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 Për mbrojtjen e konkurrencës i ndryshuar dhe Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”,

Vendosi:

- 1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt Blerje ushqime për vitin 2021 Loti I, Loti IV dhe Loti V të zhvilluara nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*
- 2. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre:*
 - a) do të ofertojnë në mënyrë të pavarur pa u konsultuar , pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurent tjetër në lidhje me cmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e cmimit , qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë , paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet apo dërgesa të vecanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin nr,9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar.*
 - b) do të operojnë me punonjësit e tyre në mënyrë të pavarur si më sipër.*
 - c) Nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektit të veprimtarisë së shoqërive respektive njëkohësisht me dy oferta të ndryshme.*
- 3. Në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK në zbatim të nenit 74 pika 1 gërma c të ligjit nr.9121/2003 ndëshkohen me gjobë deri në 10% të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.*
- 4. Monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK.*

III.1.9. Sa më sipër, KPP konstaton se Autoriteti i Konkurrencës për një hetim të shpejtë dhe efektiv për zgjidhjen e çështjes i është referuar nenit 45 të ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 Për mbrojtjen e

konkurrencës i ndryshuar i cili parashikon se: Kur Komisioni vëren shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, ai, me vendim, detyron ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve të interesuara të ndalojnë këto shkelje. Për ndalimin e shkeljes Komisioni mund të kërkojë nga ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve të interesuara të marrin masat e nevojshme, përfshirë dhe ato strukturore. Në bazë të parimit të proporcionalitetit, masat strukturore parashikohen kur masat për të vepruar ose për të mos vepruar në një mënyrë të caktuar nuk janë efikase. 2. Kur ndërmarrjet e interesuara marrin angazhime në përgjigje të vërejtjeve të bëra nga Autoriteti në vlerësimin paraprak, i cili u është komunikuar ndërmarrjeve, Komisioni, me vendim, mund t'i përcaktojë ato të detyrueshme për ndërmarrjet, në formën e kushteve dhe të detyrimeve. Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës për zgjidhjen e konfliktit i është referuar Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve” në nenin 2 të së cilës parashikohet se : Kjo rregullore zbatohet në rastet kur angazhimet eliminojnë shqetësimet e ngritura të konkurrencës, të identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Vendimi me angazhime, paraqet angazhime të ofruara nga ndërmarrjet, të cilat janë detyruese, krijojnë siguri ligjore, rivendosin konkurrencën në treg dhe sigurojnë ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme. 2. Në rastet e marrjes së një vendimi me angazhime, nuk është e domosdoshme kryerja e procedurave të plota hetimore. Vendimet me angazhime nuk kërkojnë të zbatohen të gjitha hapat procedurale që do të zbatoheshin në rastin e një vendimi përfundimtar. Rastet e “zgjidhjes me angazhime” mund të sjellin një ndryshim me të shpejtë dhe efektiv në treg. 3. Angazhimet nuk përcaktohen nga Komisioni, por depozitohen vullnetarisht dhe vendosen vetëm pas diskutimit me palët objekt hetimi. 4. Procedurat me angazhime çojnë në marrjen e vendimeve me angazhime, të cilat pas miratimit bëhen detyruese për ndërmarrjet të cilave i ’u adresohet ky vendim si dhe çon në përfundimin e procedurave hetimore .

III.1.10. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, janë konstatuar shqetësime në tregun e konkurrencës nga sjellja e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, në paragrafin 12 të arsytimit të vendimit të Autoritetit të Konkurrencës *inter allia* është shprehur se: “ Nisur nga kjo situatë e krijuar si dhe duke pasur parasysh që rastet e “zgjidhjes me angazhime” mund të sjellin një ndryshim më të shpejtë dhe efektiv në treg **Autoriteti i Konkurrencës ka identifikuar si më sipër shqetësimet e ngritura të konkurrencës të cilat mund të eliminohen me marrjen e angazhimeve nga ana e ndërmarrjeve.**” Gjithashtu, në paragrafin 17 të arsytimit të vendimit, Autoriteti i Konkurrencës ndër të tjera ka arsytuar se: “ **Shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës konsistojnë në dyshimin e një marrëveshjeje në oferta midis operatorëve ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe MC catering SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të ushqimeve të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Bashkia Tiranë, sjellje e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim, apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 pika 1 të ligjit nr.9121/2003 Për mbrojtjen e konkurrencës i ndryshuar.:** Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë natyrën e ndryshme të vendimeve të dy institucioneve të paraparë nga ligji si të pavarura. Ndërsa vendimet e Autoritetit të Konkurrencës synojnë rregullimin e konkurrencës

në tregun përkatës, vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik lidhen ngushtësisht me shqyrtimin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë në procedurën konkrete të prokurimit. Ndërkohë, hetimi paraprak dhe i kryer nga Autoriteti i Konkurrencës, në cilësinë e organit të pavarur të ngarkuar nga ligji i cili mund të vlerësojë nëse ka patur ose jo shkelje ose shqetësime të mungesës së konkurrencës, i shërbejnë Komisionit të Prokurimit Publik t'i japë zgjidhje themelit të kërkimeve të operatorëve ekonomikë ankimues. KPP thekson se një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se prej faktit rrjedh e drejta (ex facto oritur jus). Konkretisht, referuar edhe vendimmarrjes së Autoritetit të Konkurrencës, janë konstatuar shqetësime të mungesës së konkurrencës në procedurën e prokurimit objekt ankimi (ex facto) e cila ka lindur më pas të drejtën e Autoritetit të Konkurrencës (oritur jus) të ndërmarrë masa korrigjuese nëpërmjet procedurës së marrjes së angazhimeve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës që shmangin në këtë mënyrë shqetësime në të ardhmen në lidhje me mungesën e konkurrencës. KPP thekson se tre ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik janë ato të nxitjes së konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si edhe sigurimin e integritetit, besimin e publikut dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, të shprehura në gërmat c, d, dh të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Për këtë qëllim, si edhe mbështetur në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit është vendosur një shtojcë specifike “Deklaratë për Paraqitjen e Ofertës së Pavarur”, e cila megjithëse është plotësuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nga ana e institucionit përgjegjës për zbatimin dhe interpretimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës janë konstatuar shqetësime **në dyshimin e një marrëveshjeje në oferta midis operatorëve ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe MC Catering SHPK.** Në përfundim KPP, bazuar në vendimmarrjen e Autoritetit të Konkurrencës për miratimin e angazhimeve si më sipër cituar të depozituara nga operatorët ekonomikë, gjykon se deklarata për paraqitje e ofertës së pavarur e dorëzuar nga operatori ekonomik ”MC Catering” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi , nuk krijon bindjen se oferta e operatorit ekonomik MC Catering SHPK është hartuar në mënyrë të pavarur pa u konsultuar, pa komunikuar, pa bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” SHPK në rastin konkret nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pasi nuk është në përputhje me përcaktimet në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe dispozitat ligjore në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “MC Catering” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “MC Catering” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe ankimuesi nuk përmbush kriteret kualifikuese dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë

gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se “*Nga ajo që pamë ditën e dorëzimit të mostrave jemi të bindur se asnjë operator tjetër ekonomik pjesëmarrës në këtë lot nuk ka paraqitur mostra me të gjithë elementët e kërkuar sic janë dorëzuar nga MC Catering SHPK. Kërkojmë të bëhet transparent mostrat dhe dokumentacioni shoqërues i mostrave sipas kërkesave për çdo artikull respektiv dhe të na bindë KVO se kualifikimi i operatorëve ekonomikë Argent Daci dhe Kazazi është bërë në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e vendosura në kriteret e përgjithshme, kriteret e vecanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike*”, KPP sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 63, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-82107-12-14-2020, me objekt Loti I – *Blerje mish vici, mish pule dhe vezë*” me fond limit 39 274 333 (tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH,

zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 209 Protokoli, Datë 08.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri